

PREFEKTURA DIBËR

Ardhur

Nr. 443 dt 10.12.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4995

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 10/12.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 86

Datë: 05.12.2025 si dhe projekt-vendimin nr.01 Datë 26.11.2025

**“Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër,
Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





4995/11/12/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1113/1 prot.

Peshkopi, më 11.12.2025

Lënda: Për vendimin nr.86, datë 05.12.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR


DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.86, datë 05.12.2025 **“Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të administratës së Bashkisë Dibër, institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2026”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 86 Datë 05 /12 /2025

**“Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër,
Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, neni 9, pikat/c neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” pika “dh” citon “Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë”, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligji nr. 40/2023 Per disa ndryshime dhe nje shtese ne ligjin 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **05.12.2025**, me 20 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim:

VENDOSI:

Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026” sipas përshkrimit të mëposhtëm:

1. Administrata e Bashkisë Dibër

➤ Numri maksimal i punonjësve: **475**

2. Institucionet në vartësi të Bashkisë Dibër

➤ Numri maksimal i punonjësve: **74**

3. Funksionet e deleguara

- Arsimi Parashkollor 240
- Shërbimi Pyjor 10
- Ujitja dhe Kullimi 4
- MNZSH 31
- Gjendja Civile 14

Totali i funksioneve të deleguara: 299 punonjës

4. Punonjës me kontrata të përkohshme (6–8 muaj)

Për punë sezonale sipas nevojave të institucionit: **35 punonjës**

5. Efektet financiare të uljes të numrit të punonjësve të parashikuara për vitin 2026 të shtrihen në 6 mujin e parë të vitit 2026 deri në përfundim të procedurave të largimit të punonjësve.

Përmbledhje e përgjithshme e numrit maksimal të punonjësve:

Kategoria	Numri i Punonjësve
Administrata	475
Institucione në Vartësi	74
Funksione të Deleguara	299
Punonjës Sezonalë	35
Totali	883

Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
REJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Date 26/11/2025

**“Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër,
Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, neni 9, pikat c neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” pika “dh” citon “Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë”, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligji nr. 40/2023 Per disa ndryshime dhe nje shtese ne ligjin 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”

KËRKOJMË:

Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026” sipas përshkrimit të mëposhtëm:

1. Administrata e Bashkisë Dibër

- Numri maksimal i punonjësve: **475**

2. Institucionet në vartësi të Bashkisë Dibër

- Numri maksimal i punonjësve: **74**

3. Funksionet e deleguara

- Arsimi Parashkollor 240
- Shërbimi Pyjor 10
- Ujitja dhe Kullimi 4
- MNZSH 31
- Gjendja Civile 14

Totali i funksioneve të deleguara: 299 punonjës

4. Punonjës me kontrata të përkohshme (6–8 muaj)

Për punë sezonale sipas nevojave të institucionit: **35 punonjës**


5. Efektet financiare të uljes të numrit të punonjësve të parashikuara për vitin 2026 të shtrihen në 6 mujorin e parë vitit 2026 deri në përfundim të procedurave të largimit të punonjësve.

Përmbledhje e përgjithshme e numrit maksimal të punonjësve:

Kategoria	Numri i Punonjësve
Administrata	475
Institucione në Vartësi	74
Funksione të Deleguara	299
Punonjës Sezonalë	35
Totali	883

PËR BASHKINË DIBËR:


Drejtor e Burimeve Njerëzore
Malbora Lala



Drejtor e Drejtorise Ekonomik
Çeljeta Zuna



Drejtor i Drejtorise Juridike,
Ismet Saraçi



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHËU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

RELACION

“Mbi numrin e punonjësve për projekt-strukturën e Bashkisë Dibër, që pritet të hartohet dhe të miratohet për vitin kalendarik 2026”

KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, veçanërisht nenit 54 pika “dh”, ku përcaktohet se Këshilli Bashkiak miraton buxhetin vjetor të bashkisë, ndryshimet e tij, si dhe **numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, institucioneve vartëse dhe njësive administrative**, paraqitet ky relacion shpjegues për vitin 2026.

Relacioni hartohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe financiar në fuqi dhe synon të justifikojë nevojën për rishikimin dhe miratimin e numrit total të punonjësve të Bashkisë Dibër për vitin 2026, duke garantuar ofrimin e shërbimeve të pandërprera, cilësore dhe të standardizuara ndaj qytetarëve.

Hartimi i strukturës dhe planifikimi i numrit të punonjësve janë kryer duke u mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”
- Kodi i Procedurave Administrative nr.44/2015.

Treguesit e përgjithshëm të personelit për vitin 2026 do të jene si me poshte:

Numri i punonjësve të propozuar për vitin 2026 është përcaktuar në përputhje me strukturën organizative të miratuar, ngarkesën e punës së çdo njësie, rritjen e kërkesave të shërbimit ndaj qytetarëve, si dhe nevojën për funksionimin efektiv të institucioneve vartëse dhe njësive administrative.

Administrata e Bashkisë Dibër përbëhet nga **475 punonjës**, të cilët mbulojnë një gamë pozicionesh që përfshijnë:

- Pozicione të shërbimit civil
- Pozicione të tjera administrative

b) Institucionet vartëse

Numri i përgjithshëm i punonjësve: **74**, të shpërndarë si më poshtë:

- Qendra Balneare 37 Punonjes
- Qendra Kulturore 23 Punonjes
- Klubi Futbollit "Korabi" 7 punonjes
- Klubi Shumësportësh "Korabi" 7 punonjes

c) Funksionet e deleguara

Funksionet e deleguara nga qeveria qendrore, veçanërisht arsimi parashkollor, menaxhimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi, shërbimet e mbrojtjes sociale dhe gjendja civile, kërkojnë një numër të dedikuar punonjësish, të cilët financohen sipas transfertave të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Numri i përgjithshëm i punonjësve: **299**, të shpërndarë si më poshtë:

- Arsimi Parashkollor: 240 punonjës
- Shërbimi Pyjor: 10 punonjës
- Ujitja dhe Kullimi: 4 punonjës
- MNZSH: 31 punonjës
- Gjendja Civile : 14 punonjës

d) Punonjës sezonalë

Punonjësit me kontrata të përkohshme (6–8 muaj) janë të nevojshëm për përballimin e punëve sezonale, kryesisht në mirëmbajtje, gjelbërim, pastrim, shërbime publike dhe sektorë të tjerë mbështetës.

Numri i punonjësve me kontrata 6–8 muaj pritet të ulet me **15 punonjës**, duke shkuar në:

- **35 punonjës në vitin 2026**

Ky ndryshim pasqyron uljen e nevojave sezonale të administratës dhe shërbimeve të saj.

Referencë ligjore dhe bazë për relacionin

Numri i punonjësve gjithsejt dhe sipas strukturave të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse në këtë relacion është përcaktuar duke u bazuar në përcaktimet e **Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**, veçanërisht në:

- **Kreu VII – Funkcionet dhe kompetencat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**, dhe konkretisht:
 - Neni 21 – Llojet e funksioneve
 - Neni 22 – Parimet për ushtrimin e funksioneve
 - Neni 23 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
 - Neni 24 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale
 - Neni 25 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese
 - Neni 26 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit
 - Neni 27 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, dhe natyrës së biodiversitetit
 - Neni 28 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor
 - Neni 29 – Funkcionet e Bashkisë në fushën e sigurisë publike
 - Neni 30 – Funkcionet dhe kompetencat e deleguara

Ky relacion, i bashkëlidhur Projekt-vendimit **“Për miratimin e numrit gjithsejt të punonjësve të Bashkisë për vitin 2026”**, është përpiluar gjithashtu duke u referuar dispozitave të mëposhtme të ligjit 139/2015:

- **Neni 54** – Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, pika “dh”
- **Neni 64** – Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, pika “j”

Ky baze ligjore siguron që struktura e punonjësve dhe shpërndarja e tyre sipas kategorive dhe funksioneve të Bashkisë Dibër të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën e vetëqeverisjes vendore.

Në pasqyrën që vijon jepet numri i menduar për miratim i punonjësve për vitin 2026 sipas strukturave të vecanta të bashkisë, praktikë e cila do të jetë bazë për hartimin dhe miratimin e strukturës së bashkisë për vitin 2026 në forme sintetike dhe analitike.

Nr.	Emërtimi i strukturave	Nëpunës /punonjës viti 2025	Projekt, Nëpunës /punonjës viti 2026
	Administrata e Bashkise		
1.	Kryetari i bashkisë	1	1
2.	Nënkryetarë të bashkisë	2	2
3.	Sekretari i Përgjithshëm	1	1
4.	Sekretari i këshillit bashkiak	1	1
5.	Punonjes i sekretariatit te Keshillit Bashkiak	1	1
6.	Drejtorja e Integrimit European	8	8
7.	Kabineti i Kryetarit	4	4
8.	Spektori i Auditit	4	4
9.	Spektori i IMTV	5	5
10.	Drejtorja e Mardh.me me publikun	10	10
11.	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik	7	7
12.	Drejtorja e Burimeve Njerezore	39	39
13.	Drejtorja e Kopshteve dhe	30	30
14.	Drejtorie Juridike Prok.Pronave	11	11
15.	Drejtorja e Rinise ,Sporteve	5	5
16.	Drejtorja ekonomike	15	15
17.	Drejtorja e Taksave	10	10
18.	Spektori i policisë bashkiake	13	13
19.	Drejtorja e Bujqësisë	11	11
20.	Drejtorja e PPECK	6	6
21.	Drejtorja e Urbanistikes	8	8
22.	Drejtorja e Shërbimeve Publike	178	178
23.	Njësitë Administrative	105	105
	Institucione ne varësi		
24.	Pallati i Kulturës	23	23
25.	Klubi Futbolli "Korabi"	7	7
26.	Klubi Shumësportësh "Korabi"	7	7
27.	Qendra Balneare "Enver Shehu"	37	37
	Funksione te deleguara		
28.	Drejtorja e MZSH-s	31	31
29.	Zyrat e gjendjes civile	14	14
30.	Spektori i Pyjeve dhe Kullotave	10	10
31.	Spektori i Administrimit të Ujërave	4	4
32.	Arsimi Parashkollor	240	240
33.	Punonjes sezonal	50	35
	TOTALI	898	883

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935

Planifikimi i numrit total të punonjësve për vitin 2026 është kryer në përputhje me:

- analizën buxhetore,
- legjislacionin në fuqi,
- nevojat reale të shërbimeve,
- kërkesat e qytetarëve,
- praktikat e bashkive të mëdha të vendit.

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për miratimin e Projekt-vendimit "Për miratimin e numrit gjithsej të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026".

Drejtore e Burimeve Njerëzore

Malbora/Lala

